

INSPEKTORATI SHITETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI KORRIK 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	19.06.2025	Kërkese- Ankesë për një shqetesim që po ndodh rëndom kohet e fundit. Ka filluar ne disa te arштуapajtura "pika te sajuaara karburanti", që te furnizohen me karburante automjete te rrethinave. Keto "Pika furnizimi", thjesht jane sajuar me depozita që nuk u dihet pronesia. Ne te tregtohen karburante jashte kushteve teknike dhe kerkesave ligjore, per me teper nuk paguaje asnje lloj detyrimi tatimor, taksa e tarifa. Duke pare keto veprime te jashteligjeshme, te ndemarra nga individë te ndryshem, jemi te detyruar tu informojme, pasi ne kete menyre cenohet konkurrenca e ndershme ne fushen e tregimitit te karburanteve. Jane tre pika te ndryshme ku eshte evidentuar ushtrimi i veprimtarise se tregimitit te karburantit pa asnje certifikim apo dokumentacion ligjor që jep te drejten e ushtrimitit te kesaj veprimtarie, konkretisht: Tek kapanoni mbahet karburant per shitje ne nje depozite5 toneshe; . Vendi njihet si Lavazh, por aty eshte instaluar nje depozite 10 toneshe, ku tregtohet karburant. Shoqeria jone, duke qene e penalizuar shume nga nderhyjen e paligjishme dhe konkurrenca e pandershme, eshte e detyruar te ankohet deri ne instancat me te larta shitetore.	21.07.2025	Në përgjigje të email-it Tuaj, dërguar me datë 17.07.2025, Protokolluar në ISHTI me Nr. 6364 Prot datë 18.07.2025 ku informoni që ankesën Tuaj për 4 pika që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregimitit me pakicë të karburanteve pa licenca tregtimi, ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organi shtetëror i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë që kryejnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimitit të naftës dhe nënprodukteve të tyre në zbatim të ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në vijim të email-it për të njëjtën problematikë të dërguar nga ana juaj me email me datë 19.06.2025 Protokolluar në ISHTI me Nr. 4704 Prot datë 20.06.2025, Grupi i inspektorëve të ISHTI kanë ushtruar kontroll sipas adresave të objekteve ku ju keni paraqitur problematikën Tuaj. Në përfundim të kontrollit të ushtruar kanë mbajtur informacion me shkrim protokolluar me Nr. 4704/2 Prot datë 03.07.2025 shoqëruar dhe me foto për të cilin ju jeni informuar nga ISHTI. Pajisja me licenca për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrat lubrifikantë dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë bëhet nga organet e qeverisjes vendore sipas juridiksionit përkatës sipas përcaktimeve të VKM Nr.970, datë 02.12.2015 " Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënen e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve te saj " i ndryshuar	E plotë	0
2	23.06.2025	Kërkese- Ankesë nga një qytetar i cili raporton për një rrezik të mundshëm që vjen nga një restorant peshku që operon në katin e parë të një pallati të banuar Ky lokal përdor bombola gazi, gjë që përbën rrezik real për sigurinë e banorëve të pallatit për shkak të mundësisë së rrjedhjes së gazit,shpërthimit apo zjarrit,erës që ajo leshon dhe dëmon shëndetin. Kërkohet të inspektohet për të verifikuar nëse ky subjekt respekton standartet teknike dhe ligjore për përdorimin e gazit në ambient.	01.07.2025	Në përgjigje të ankesës, ardhur në ISHTI, datë 23.06.2025, lidhur me subjektin u ngrit grupi i punës me inspektorë nga Drejtoria e Pajisjeve Nën Presion. Grupi kreu verifikimet në terren, dhe nga verifikimi rezultoi se subjekti dispononte vetëm një bombol GLN me vëllim 15 kg i vendosur në ambientin e kuzhinës së restorantit dhe ishte brenda kushteve teknike. Bombola ishte e pajisur me Deklaratën e Konformitetit CE nga prodhuesi, dhe nuk paraqet rrezikshmëri ndaj palëve të treta dhe ambientit që rrethon.	E plotë	0
3	26.06.2025	Paraqes ankesen time ne lidhje me subjektin qe ushtron aktivitetin ngjitur me hotelin tim . Subjekti ne fjale disponon dhe nje rezervuar GLn. Kerkoj nga institucioni juaj te verifikohet subjekti ne fjale ne lidhje me instalimin e rezervuarit te gln, ne qofte se i permblush kushtet per pendorim te sigurte sipas kushteve ligjive dhe normave shqiptare. Jam ne pritje te shqyrtimit te ankeses nga ana juaj si institucioni kompetent sepse pervec sigurise por nga ana e klienteve te hotelit qe shumica jane shietas te huaj kane shprehur shqetesimin e tyre ne lidhje me kte situate	09.07.2025	Në vijim të ankesës, për subjektin u ngrit grupi i punës me inspektorët, të cilët kryen verifikimin në terren. Nga verifikimi u konstatua se subjekti dispononte pajisje nën presion për nevojat e tij teknologjike, e cila disponon dokumentacion të rregullt tekniko-ligjor dhe plotëson kushtet thelbësore të sigurisë sipas Ligjit nr. 32/2016 dt 24.03.2016, “ Për garantimin e sigurisë së punës së pajiseve dhe instalimeve nën presion “ Dokumentacioni tekniko ligjor vijon si më poshtë: Projekti Teknologjik i rezervuarit GLN, me vëllim 1000 lit, Vitetimi i Përpunshmërisë së Projektit Teknologjik, Akt Teknik Montimi/Instalimi i Pajisjes nën Presion Certifikata e Konformitetit të Inspektimit të Rezervuarit te GLN, Subjekti ka të instaluar rezervuarin dhe plotëson të gjitha kushtet dhe kërkesat thelbësore të sigurisë sipas dokumentacionit më sipër.	E plotë	0
4	28.06.2025	Dëshiroj të bëj një denoncim zyrtar për subjektin që kryen aktivitetin prodhim alkulloresh dhe që vepron ë kundërshtim me standardet teknike, të sigurisë dhe ato industriale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Shkeljet që kjo fabrike kryen janë si më poshtë:Përdorimi i pajisjeve pa certifikim teknik Pajisjet e prodhimit (makineritë ftohëse dhe përpunuese) nuk janë të certifikuara nga entet përkatëse dhe nuk kanë kaluar kontrollet periodike.Ekziston rrezik i lartë për defekte teknike që mund të çojnë në aksidente. Mosrespektimi i standardeve të sigurisë teknikeNuk ka sinjalistikë sigurie në ambientet e prodhimit. Nuk përdoren pajisje mbrojtëse për punonjësit (veshje, doreza, mbrojtëse etj.). Shfrytëzimi i bombolave të gazit/ftohjes jashtë kushteve teknike Bombolat për ftohje ose përdorim teknologjik mbahen në ambiente të pasigurta dhe pa dokumentacion mbi kontrollin teknik.Kjo përbën rrezik të drejtpërdrejtë për shpërthim ose rrjedhje të gazrave të rrezikshëm. Mosrespektimi i kushteve për ambientet industriale Mungon ventilimi i duhur në ambientet e prodhimit, duke rritur rrezikun për përqendrim të dëmshme të gazrave apo lagështirë që ndikon në makineritë elektrike. Pajisjet elektrike nuk janë të izoluar siç kërkohet në ambiente të lagështa apo me ngarkesë të lartë pune. Mosmbajtja e regjistrave teknikë Fabrika nuk disponon dokumentacion mbi mirëmbajtjen periodike të pajisjeve, verifikimet teknike, apo autorizimet për funksionimin e linjave industriale. Ju lutem të merrni këtë ankesë në konsideratë dhe të kryeni një inspektim teknik në ambientet e kësaj fabrike sa më shpejt të jetë e mundur, për të parandaluar çdo rrezik të mundshëm që kërcënon sigurinë e punonjësve dhe komunitetin përreth. Mbështetur në detyrimin ligjor për transparencë dhe siguri teknike, presim që të merren masat përkatëse sipas ligjit.	02.07.2025	Në përgjigje të ankesës tuaj ju bëjmë me dije se u ushtrua kontroll nga inspektorët e ISHTI-it . Nga inspektimi i kryer pranë këtij subjekti, u konstatua se ky subjekt për nevoja teknologjike ka të instaluar pajisje nën presion, për të cilat disponon dokumentacionin tekniko-ligjor si më poshtë vijon; Dy Projekte Teknologjike të impiantit të furnizimit me ajër të ngjeshur dhe impiantit të furnizimit me GLN të kaldajave për prodhimin e ujit të ngrohtë të cilat janë hartuar nga Ing. Harens Ruli, Nr. Lic. 95. Vlerësimet e Konformiteteve të këtyre projekteve teknologjike, Dëshmi Aftësie të punojësit për përdorimin e pajisjeve nën presion, me Nr. Çertifikatë AQS/T/S91362022 më datë 28.01.2022 Kontratë për sigurimin e përgjegjësisë civile ndaj palëve të treta, l Çertifikatat e konformitetit të inspektimit teknik periodik të pajisjeve të lëshuara nga OMI “EPAS CERTIFY“ SH.P.K me Nr. E-ENP:24/0001 më datë 11.12.2024; OMI “ERGI-PINK“ SH.P.K me NS:0053 më datë 01.02.2025; OMI “M.F.M. “ SH.P.K. m Përsa më sipër subjekti disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjorë për përdorimin e pajisjeve nën presion si dhe këto pajisje (PNP) plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit 32 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajiseve dhe instalimeve nën presion”.	E plotë	0

5	12.07.2025	Konstatim instalim rezervuara/tank gazi ne shkelje te ligjit dhe kushteve teknike. Venie ne rrezik te jetes nga shperthime te mundshme zjarri nga pakujdesia, veprime aksidententale apo kushte meteorologjike. Kërkoje nderhyrjen e inspektoriat per te marre masat e menjhershme.	28.07.2025	Në vijim të ankesës, ardhur në ISHTI, datë 12.07.2025, për subjektin u grit grupi i punës me inspektorët. Nga verifikimi u konstatua se subjekti dispononte pajisje nën presion për nevojat e tij teknologjike, e cila disponon dokumentacion të rregullt tekniko-ligjor dhe plotëson kushtet thelbësore të sigurisë sipas Ligjit 32/2016 datë 24.03.2016. Dokumentacioni tekniko ligjor vijon si më poshte: Projekt Teknologjik i rezervuarit GLN, me vëllim 1000 lit, ; Vërtetimi i Përputhshmerise se Projektit Teknologjik, Akt Teknik Montimi/Instalimi i Pajisjes nën Presion, Çertifikata e Konformitetit të Inspektimit të Rezervuarit të GLN, k Çertifikat/Dëshmi Afësie (Personat që përdorin pajisje nën presion)- Gjithashtu është kryer kontrolli fizik i pajisjes nën presion dhe rezultoi se pajisja plotëson kushtet e sigurisë teknike sipas Ligjit 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion" dhe Rregullave Teknik përkatës dhe u vërtetua se pajisja është e instaluar duke respektuar Projektin Teknik. Depozita është mbitokesore, e vendosur mbi një bazament betoni sipas kriterëve të sigurisë bazuar në rregullat teknike për depozitat mbitokesore, me permasat 160 cm x 227 cm.Eshte respektuar rrezja e sigurisë me një distance prej 15m nga objektet përreth.Gjithashtu është bërë edhe tokezimi i depozites. Konkluzion: Subjekti ka marrë masat që të sigurojë jetën dhe shëndetin e individëve, vlerave materiale dhe ndikimit në mjedis	E plotë	0
6	16.07.2025	Kërkesë nga një shoqëri e tregimit me shumicë të Nafitës Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre dërgimin e Raport Testimeve të produkteve që importon subjekti..	17.07.2025	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) si organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontroll në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Bazuar në kërkesën ardhur nga platforma e Bashkëqeverisjes e Shqipërisë që Duam, në lidhje me venien në dispozicion të dokumentacionit ligjor, raport analizat e kryera për produktet e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, ju bejme me dije se, sipas kërkesave të akteve nënligjore në fuqi, Urdhëri nr 6, datë 09.01.20215, paragrafi II pika 4, gërma b) Mostra merret nga punojësit e ISHTI të pajisur me autorizime nga ana e titullarit të institucionit. Për shoqëritë e tregimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj: Për sasitë e importuar në pikat doganore, për çdo produkt dhe për çdo ndarje fizike të mjetit transportues (anije, vagon/cistern hekurudhore, autobus, fuçi). Për rastin e importit të GLN me vagona cisternë dhe/ose autobus për arsye të sigurisë teknike, mostëmarrja të bëhet në çastin e shkarkimit të produktit në depozita. Nga ana e ISHTI është realizuar mostër marrja për të gjitha produktet e parazhdoganimit ku është kryer dhe analizat pranë laboratorit qëndror të Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në lidhje me cilësinë sipas standardeve në fuqi. Pas daljes së raport testimeve nga ana jonë janë marr masat për vënien në dispozicion të të gjithave raport testimeve në rrugë zyrtare përmes shërbimit postar, Posta Shqiptare SHA. I gjithë ky dokumentacion i është vënë në dispozicion shoqërisë suaj pranë njërit prej pikave ku ushtroni veprimtarinë në fushën e hidrokarbureve. Nga ana jonë rezultoi pranë librit të korespondencës së Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) të jenë nisur të gjitha raport testimet të identifikua si më poshte sipas numrave të protokollit, në adresën e kërkuar	E plotë	0
7	17.07.2025	Informacion për adresimin e ankesës në institucione të tjera nga përfaqësuesi i subjektit për ushtrimin e aktivitetit në fushën e tregimit me pakicë të hidrokarbureve pikave të karburantit të palicencuara.	18.07.2025	Në përgjigje të email-it Tuaj, dërguar me datë 17.07.2025, Protokolluar në ISHTI me Nr. 6364 Prot datë 18.07.2025 ku informoni që ankesën Tuaj për 4 pika që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregimit me pakicë të karburanteve pa licenca tregtimi do ta drejtoni në institucione të tjera, ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organi shtetëror i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë që kryejnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës dhe nënprodukteve të tyre në zbatim të ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në vijim të email-it për të njëjtën problematikë të dërguar nga ana juaj Grupi i inspektorëve të ISHTI kanë ushtruar kontroll sipas adresave të objekteve ku ju keni paraqitur problematikën Tuaj. Në përfundim të kontrollit të ushtruar kanë mbajtur informacion me shkrime me foto për të cilin ju jeni informuar nga ISHTI. Pajisja me licenca për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrat lubrifikantë dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë bëhet nga organet e qeverisjes vendore sipas juridiksionit përkatës sipas përcaktimeve të VKM Nr.970, datë 02.12.2015 " Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj " i ndryshuar	E plotë	0